

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Ju falënderoj për praninë tuaj këtu dhe për vëmendjen që po i kushtoni shënimit të 20 vjetorit të themelimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Unë sot jam shumë i lumtur që në këtë ngjarje shumë të rëndësishme për ne, na u ka bashkëngjitur edhe Zëvendëspresidenti i Fondit Monetar Ndërkombëtar, z. Tao Zhang, i cili në vazhdimësi ka treguar përkushtim të lartë për të siguruar vazhdimësinë e mbështetjes së FMN-së ndaj BQK-së dhe Kosovës në përgjithësi. Mbështetja e FMN-së për BQK-në ka qenë në vazhdimësi shumë e rëndësishme që nga themelimi i saj, prandaj për ne është shumë e rëndësishme që të arriturat tona gjatë këtyre 20 viteve t'i ndajmë me ata që dhanë kontribut shumë të rëndësishëm për zhvillimin tonë.

Me angazhimin dhe përkushtimin shumë të lartë të të gjithë punonjësve të BQK-së, si dhe me mbështetjen e pakursyer të institucioneve vendore dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, BQK ka arritur t'i zhvillojë të gjitha kapacitetet e saj në linjë me standardet ndërkombëtare bashkëkohore në fushën e bankingut qendror dhe sot i ofron ekonomisë së vendit të gjitha shërbimet që i ofron një bankë qendrore moderne.

Të arriturat e BQK-së gjatë këtyre 20 viteve më së miri pasqyrohen në sistemin financiar që kemi arritur ta zhvillojmë gjatë këtyre viteve, ku sot kemi një sistem të shëndoshë dhe me kontribut çdo ditë e më të madh në zhvillimin ekonomik të vendit.

Spektori bankar i Kosovës sot është njëri ndër sektorët më të shëndetshëm bankarë në të gjithë rajonin, përderisa zvogëlimi i normave të interesit dhe rritja e vazhdueshme e kreditimit kanë lehtësuar në masë të madhe qasjen në financa për ekonomitë familjare dhe bizneset. Të dhënat

e fundit tregojnë se norma vjetore e rritjes së kredive të sektorit bankar bankar është 10.1%, përderisa norma e kredive joperformuese vazhdon të jetë në nivel të ulët prej vetëm 2.2%.

Zhvillime pozitive kemi edhe në komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës, siç janë fondet pensionale, kompanitë e sigurimit, si dhe institucionet mikrofinanciare dhe ato jobankare.

Ne jemi të vetëdijshëm se na presin edhe shumë sfida në të ardhmen por jemi të sigurt se me kapacitetet që kemi ndërtuar gjatë viteve dhe me mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë ndërkombëtarë, do të jemi të suksesshëm në tejkalimin e tyre, duke e ruajtur stabilitetin financiar dhe duke e vënë sistemin financiar në shërbim edhe më të madh të zhvillimit ekonomik të vendit.